- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

### Shtojca 7/1

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik ]

## DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

## Dokumentat standarde të tenderit

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_**

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

### **Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:**

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*

c. *Sigurimi i ofertes, (nëse është i zbatueshëm) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 7/1;*

e. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001. Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë në punë, sipas standardit ndërkombëtar ISO 18001 ose ISO 45001. Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar

## Dokumentat standarde të tenderit

nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

*Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes.*

### **3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1.Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në vitet 2016,2017 dhe 2018, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

2.Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

### **3.3 Kapaciteti teknik**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.
  - b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.
2. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) persona të punësuar, të siguruar për periudhën Nëntor 2019 – Janar 2020. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
  - ✓ Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Nëntor 2019 – Janar 2020.
  - ✓ Listepagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Nëntor 2019 – Janar 2020.
3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, personin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër.
4. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, të vërtetuar me kontrate shit-blerje ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi për pajisjet e mëposhtme:
  - Makinë korrëse bari, minimuni 1 (një) copë;
  - Kazanë plehrash teknologjike (me mekanizëm), minimuni 6(gjashtë) copë;
  - Kosha të vegjel mbeturinash për tu vendosur në anë të rrugëve, minimuni

18(tetëmbëdhjetë) copë;

- Karrela për pastrimin, minimuni 5(pesë) copë.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## Shtojca 9

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Pastrimi i brendshëm i organizuar nga ana e një sipërmarrje private që ka për detyrë pastrimin dhe dezinfektimin përditshëm në të 365 ditët e vitit e të gjitha sipërfaqeve të pavioneve, dhomat e të sëmurëve, ballkonet, korridoret, tualete, dhoma dushi, dhomat e shërbimit për mjekët, infermierët, kabinetet, zyrat, ambjentet e shfrytëzueshme në bodrume dhe shkallët deri në dalje nga ndërtesa; bën pastrimin dhe dezinfektimin e mureve dhe inventarit në dhoma, sipas specifikimeve teknike si më poshtë :

#### **Pastrimi i ambienteve të brendshme që do të bëhet çdo ditë sipas specifikave të mëposhtme :**

- **Dhomat e pacientëve** të pastrohen jo më pak se 3(tre) herë në ditë dhe në raste të vecanta edhe më tepër sipas nevojës. Gjate 8 orarshit për secilin turn do behet mirmbajtja e pastrimit të ambienteve ku secili turn do të mbulojë nevojat për pastrim të sipërfaqes së dyshemësë. Me pastrim të dhomës do të kuptohet marrja e pluhurave mbi mobiljet dhe cdo paisjeje tjetër që ndodhet brënda sipërfaqes së dhomës. Larje të Dyshemese me solucione të lejueshme për përdorim në ambientet spitalore. Qeset e mbeturinave të zbrazen jo më pak se dy herë në ditë dhe sipas rastit në cdo moment të ditës. Pastrimi në dhoma nuk bëhet në orarin e ngrënies së ushqimit dhe në oraret e kryerjes së vizitave të mjekut.

- **Korridorët, shkallët dhe ashensorët** të pastrohen jo më pak se 3 (tre) herë në ditë dhe në raste të vecanta edhe më tepër sipas nevojës. Gjate 8 orarshit për secilin turn do behet mirmbajtja e pastrimit të ambjentëve ku secili turn do të mbulojë nevojat për pastrim të sipërfaqes së dyshemesë. Solucionet që do të përdoren duhet të jenë të lejueshme për këto ambiente.
- **Pastrimi i Tualeteve** në dhomat e pacientëve do të bëhet sipas nevojave ditore në pavione. Për tualetet kolektive jo më pak se 4 herë në ditë. Tualetet e personelit të pastrohen 3 herë në ditë sipas turneve. Mbas çdo pastrimi të bëhet dhe dizinfektimi i tyre. Pastrimi i sifonëve të tualeteve sipas nevojave ditore në pavione. Larja bëhet me solucion dizinfektues. Në ambientet e tualeteve të përdoren solucione aromatike.
- **Pastrimi i zyrave dhe dhomave të personelit (mjekësor dhe atij mbështetës), laboratorët, farmacia, ergoterapia**

Me këtë shërbim do të kuptojmë: Heqja e mbeturinave nga koshat, fshirja e larja e dyshemeve, larja e xhamave dhe marrja e pluhurave në të gjitha orenditë e vendosura në zyrë. Në dhomat e personelit ky pastrim të bëhet të paktën 1 herë në ditë. Laboratorët, Ergoterapia dhe farmacia të pastrohen të paktën 2 herë në ditë. Solucionet që do të përdoren duhet të jenë të lejueshme për këto ambiente.

- **Pastrimi i shtëpive mbështetëse**

Me këtë shërbim do të kuptojmë: Heqja e mbeturinave nga koshat, fshirja e larja e dyshemeve me solucion përkatës dhe marrja e pluhurave në të gjitha orenditë e vendosura në këto ambiente. Ky pastrim të bëhet të paktën 2 herë në ditë.

#### **Pastrimi i ambienteve të brendshme që do të kryhet të paktën një herë në javë**

- Të pastrohen sipërfaqet e mureve dhe tavaneve. Aty ku muri është i lyer me bojë vaji apo pllaka të lahen me solucion.
- Të zhvendosen dollapet dhe mobiljet e mëdha dhe të pastrohet pjesa e mbrapme e tyre.
- Të pastrohen dritaret e fasadës si dhe dritaret e brendshme me solucion larës.
- Të pastrohen dyert e brendëshme dhe të jashtme me solucion larës.
- Pastrimet javore të bëhen sipas grafikut në ditën e përcaktuar.

#### **Pastrimi i ambienteve të brendshme që do të kryhen të paktën një herë në muaj**

- Do të pastrohet sistemi i të gjithë llojeve të ndriçimit (abazhurë, llampadarë etj).
- Pastrimet mujore të bëhen sipas grafikut në ditën e përcaktuar.

#### **Dhomat e mjekimit**

- Të pastrohen sa herë që është e nevojshme gjatë gjithë kohës që janë në përdorim.

### **Të gjitha dhomat**

➤ Dhomat e pacientëve, infermieritë, dhoma e mjekimit, zyrat, ambientet e përbashkëta, laboratorit, ergoterapitë, parukeritë, palestra, magazina, kuzhina etj., duhet të pajisen koshat me qese plastike të zeza njëpërdorimshe për hedhjen e mbeturinave.

Dezinfektimi i dyshemeve, qosheve dhe tualeteve bëhet me lëndë dezinfektuese çdo ditë behet me lëndë dizinfektuese me bazë klori 5% (hipoklorit) cdo ditë. Kur përdoren dezinfektantë duhet të zbatohen pikat e përgjithshme të Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore. Produktet që do të përdoren për dezinfektim duhet të jenë të certifikuara.

Pastrimi i sipërfaqes bëhet me shtupë me dy kova ujë, një për larje, një për shplarje. Mjetet e pastrimit për tualetet mbahen të veçanta, fshesa përdoret e kufizuar në ambientet pa shtretër dhe që kanë qarkullim të lartë (shkallë, koridore, etj.)

Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për në vend grumbullimin e plehrave bëhet çdo ditë, transporti bëhet me kosha të mëdhenj, të posaçem, të mbyllur me kapakë.

Sanitaria gjatë pastrimit nuk duhet të prekë pacientet, aparaturat, dorezat e dyerve.

Personeli i shërbimit duhet të ketë uniformë të dallueshme nga personeli spitalor. Në uniformë duhet të dallohet logo e kompanisë, me ngjyrë të ndryshme nga uniforma e spitalit. Personeli duhet të instruktohet për mbrojtjen nga infeksionet spitalore sipas ligjit *“Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve ngjitëse”*.

1. Në ambientet spitalore personeli i pastrimit duhet të përdori mjete mbrojtëse si doreza plastike, maska, këpucë gome etj.
2. Në ambjentet publike si koridore, salla, shkallë etj., të përdoren tabela provizore ku të paralajmërohet për dysheme të lagur e të rrëshkitshme.
3. Shërbimi i pastrimit duhet të vazhdojë gjatë 24 orëve pa ndërprerje (sipas ndarjes së orareve të përcaktuara në këtë argumentim).
4. Te siguroje numrin e nevojshem te personelit per kryerjen e pastrimit ne te gjithe teritoret e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore. Ky personel duhet te jete i pershtatshem dhe i instruktuar per kryerjen e sherbimit te pastrimit, sipas rregullave dhe duhet te jete i pajisur me librezat shendetesore personale.
5. Te siguroje bazen materiale te inventarit per pastrim si dhe materialet dezinfektante te pershtateshme dhe te lejueshme per perdorim ne ambjentet spitalore. Siguron inventarin per grumbullimin e mbeturinave ne dhoma, korridore etj.
6. Per personelin e pastrimit siguron veshjet dhe mjetet mbrojtese ne pune te cilat do te jene specifike dhe me mbishkrimin perkates.
7. Pastrimi do te behet i perditshem ne te 365 ditet e vitit.

Pastrimi i dritareve dhe mureve behet çdo jave ne ditet e caktuara ne grafik.

Pastrimi ne dhoma nuk behet ne orarin e ngrenjjes se ushqimit dhe ne oraret e kryerjes se vizitave te mjekut.

Kontraktuesi kur merr ambjente ne perdorim nga e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore paguan qerane perkatese ne baze te VKM ne fuqi. Me mbarimin e kontrates i dorezon ato ne gjendje te rregullt. Shpenzimet qe ben per riparimin, mirembajtjen e nevojshme perballohen nga vete sipermarresi.

Kontraktuesi nderton stafin e vet drejtues. Ai cakton pergjegjesin e vet te pastrimit i cili



ndjek, organizon e drejton punen ne spital.

### **Kontraktuesi ka per detyre:**

- të sigurojë me shpenzimet e veta pajisjet, makineritë dhe veglat e punës që nevojiten për përmbushjen e kontratës. Këto pajisje, makineri dhe vegla duhet që sipërmarresi ti sigurojë që me fillimin e punës.
- Makineritë dhe veglat e punës:

1. Karrela për pastrimin (jo me pak se 5 Karrele) me të gjitha mjetet e nevojshme për pastrim dhe çdo mjet pune tjetër të nevojshëm për kryerjen e shërbimit të pastrimit.

Të gjitha makineritë dhe veglat e punës Kontraktuesi duhet ti ketë gjëndje në inventarin e tij ose me kontratë qiraje.

### **Pastrimi i jashtem**

Me sipërfaqet e jashtme (rrugë, trotuare, sheshe) të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore do të kuptojmë të gjithë hapësirën rreth e përqark godinave (objektet e ndërtimit) që aktualisht janë në funksion të këtij spitali.

Territori i spitalit shtrihet ne nje siperfaqe prej 12.500 m<sup>2</sup> dhe Qendra Komunitare shtrihet ne nje siperfaqe 1500 m<sup>2</sup>; e cila ndahet si vijon:

### **Per objektet qe ndodhen brenda teritorit te Spitalit**

- Siperfaqia truall brenda murit rrethues te Spitalit sot eshte **12.500 m<sup>2</sup>**
- Siperfaqe truall brenda rrethues sipase planit rregullues te Bashkise mbetet **10.740m<sup>2</sup>**
- Siperfaqe e zene me ndertime ekzistuese eshte **2.253 m<sup>2</sup>** , kati i dyte ne pavionin 4-5 eshte 420 m<sup>2</sup>
- Siperfaqia e zen me ndertimin e shtepise Mimoza eshte **180 m<sup>2</sup>** (ndertese dy kate me siperfaqe ndertimi 360m<sup>2</sup> sot perdoret si P.A.S)
- Siperfaqe e zen me ndertimin e ri eshte **988 m<sup>2</sup>**(3\*988=2964m<sup>2</sup>)
- Siperfaqe totale e zen me ndertim eshte **3.421 m<sup>2</sup>** (2253m<sup>2</sup> ekzistuese , 180m<sup>2</sup> shtepia Mimoza 988 m<sup>2</sup> ndertimi i ri
- Siperfaqe e zene me rruge  $\approx$  **3900 m<sup>2</sup>**
- Siperfaqe e gjelberuar  $\approx$  **3419 m<sup>2</sup>**

### **Te dhena per ambjentet ne territorin e Qendres Komunitare**

- Siperfaqia Brenda murit rrethues eshte  $\sim$ **1500 m<sup>2</sup>**
- Siperfaqia e zene me ndertim eshte 450 m<sup>2</sup> x per tre kate = 1350 m<sup>2</sup>
- Siperfaqja e zene me rruge eshte  $\approx$  550 m<sup>2</sup>
- Siperfaqja e gjelberuar eshte  $\approx$  500 m<sup>2</sup>

Sipas te dhenave te mesiperme nxjerrim se siperfaqe totale ndertime eshte:

$$2253 + 420 + 2964 + 360 + 1350 = 7347 \text{ m}^2$$

Siperfaqe totale e zene me rruge eshte:

$$3900 + 550 = 4450 \text{ m}^2$$

## Dokumentat standarde të tenderit

Sipërfaqe e gjelbert është:

$$3419 + 500 = 3919 \text{ m}^2$$

Shërbimi i pastrimit të jashtëm përbehet nga keto procese pune:

Nr.	Pershkrimi i procesve te punes	Nj.m	Siperfaqja
1.	Fshirje rrugesh (3900m <sup>2</sup> +550m <sup>2</sup> )	m <sup>2</sup>	4,450
2.	Pastrim rrugesh (3900m <sup>2</sup> +550m <sup>2</sup> )	m <sup>2</sup>	4,450
3.	Larje rrugesh (3900m <sup>2</sup> +550m <sup>2</sup> )	m <sup>2</sup>	4,450

Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë me shpenzimet e veta pajisjet, makineritë dhe veglat e punës që nevojiten për përmbushjen e kontratës. Keto pajisje, makineri dhe vegla duhet që kontraktuesi t'i ketë në dispozicion që me fillimin e punës.

Nr.	Emertimi	Nj.m	Sasia
1.	Makine korrese bari	cope	1
2.	Kazane plehrash teknologjike	cope	6
3.	Kosha të vegjel mbeturinash anës rrugëve	cope	18

Kontraktuesi do të pastroj çdo ditë të gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë sipërfaqen prej 4,450 m<sup>2</sup>, kur është e nevojshme edhe 2 herë në ditë, do të pastroj bordurat në anësoret e rrugëve nga barerat dhe do të lyej bordurat me gëlqere një herë në muaj. Kontraktuesi do të kryej larjen e rrugëve çdo ditë herët në mëngjes, para orës 7.00 për periudhën 15 Mars - 30 Tetor, pra gjithsej 230 ditë për një sipërfaqe prej 4,450 m<sup>2</sup>. Kontraktuesi do kryej çdo ditë transportin e mbeturinave, (kur është e nevojshme edhe 2 herë në ditë) të cilat janë përqendruar në 1 pikë grumbullimi me 6 kazane brenda territorit të spitalit.

Shërbimi i Pastrimit të ambienteve të jashtme që kërkohet do të jetë 16-orarësh sipas tabelës me të dhënat e sipërfaqeve si më poshtë:

Nr	Sipërfaqet e jashtme	Njësia	Sasia	Frekuenca dite/vite	Sasia vjetore
1	Fshirje Rrugë	m <sup>2</sup>	4 450	365	1 624 250
2	Pastrim Rruges	m <sup>2</sup>	4 450	365	1 624 250
3	Larje Rruges	m <sup>2</sup>	4 450	230	1 023 500

- Me pastrim të jashtëm do të kuptohet pastrimi i sipërfaqeve të rrugëve, trotuareve, shesheve dhe të gjithë territorit pjesë që aktualisht përdoret nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë
- Bordurat duhet të mirëmbahen dhe lyhen me gëlqere të paktën një herë në muaj.
- Pastrimi i territorit do të kryhet jo më pak se një herë në ditë. Pjesët e asfaltuara dhe të betonuara do të lahen me ujë të paktën 1 (një) herë në ditë sipas sezonit për të eliminuar pluhurat dhe mikrobet (por jo në ditët me shi).
- Territori i Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë në çdo moment duhet të jetë i pastër nga

## Dokumentat standarde të tenderit

- mbeturinat e ndryshme si letra, shishe plastike, amballazhe të ndryshme etj.
- Mbeturinat që do të pastrohen të futen në qese plastmasi dhe të cohen në pikat e grumbullimit të mbeturinave. Duhet ndërruar të paktën një herë në ditë qeset plastike në koshat e vendosura në territorin e jashtëm të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore
  - Në asnjë rast mbeturinat të mos digjen.
  - Sipërmarresi kryen larjen e rrugëve cdo ditë herët në mëngjes, para ores 7.00 për periudhen 15 Mars - 31 Tetor, pra gjithsej 230 ditë.

### Shtojca 10

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

#### **PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>		
<b>02</b>		
<b>03</b>		
<b>...</b>		

**Shtojca 11**

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet:

<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i shërbimeve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Frekuenca/12 muaj</b>
a	Pastrim i brëndshëm	m2	<b>7,347</b>	<b>365</b>
b	Pastrim i jashtëm			
1	Fshirje rrugësh	m2	<b>4,450</b>	<b>365</b>
2	Mirëmbajtje rrugësh	m2	<b>4,450</b>	<b>365</b>

Dokumentat standarde të tenderit

3	Larje rrugësh	m2	4,450	230
---	---------------	----	-------	-----

Afatet e ekzekutimit:

Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër 12 muaj.

## Shtojca 12

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### **TERMAT E REFERENCËS**

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:** “Shërbim i pastrimit të ambjenteve të brendshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, brenda marrëveshjes kuadër si vijon:

#### **Dhomat e mjekimit**

➤ Të pastrohen sa herë që është e nevojshme gjatë gjithë kohës që janë në përdorim.

#### **Të gjitha dhomat**

➤ Dhomat e pacientëve, infermieritë, dhoma e mjekimit, zyrat, ambientet e përbashkëta, laboratorit, ergoterapitë, parukeritë, palestra, magazina, kuzhina etj., duhet të pajisen koshat me qese plastike të zeza njëpërdorimshe për hedhjen e mbeturinave.

Dezinfektimi i dyshemeve, qosheve dhe tualeteve bëhet me lëndë dezinfektuese çdo ditë behet me lëndë dizifektuese me bazë klori 5% (hipoklorit) cdo ditë. Kur përdoren dezinfektantë duhet të zbatohen pikat e përgjithshme të Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore. Produktet që do të përdoren për dezinfektim duhet të jenë të certifikuara.

Pastrimi i sipërfaqes bëhet me shtupë me dy kova ujë, një për larje, një për shplarje. Mjetet e pastrimit për tualetet mbahen të veçanta, fshesa përdoret e kufizuar në ambientet pa shtretër dhe që kanë qarkullim të lartë (shkallë, koridore, etj.)

Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për në vend grumbullimin e plehrave bëhet çdo ditë, transporti bëhet me kosha të mëdhenj, të posaçem, të mbyllur me kapakë.

Sanitaria gjatë pastrimit nuk duhet të prekë pacientet, aparaturat, dorezat e dyerve.

Personeli i shërbimit duhet të ketë uniformë të dallueshme nga personeli spitalor. Në uniformë duhet të dallohet logo e kompanisë, me ngjyrë të ndryshme nga uniforma e spitalit. Personeli duhet të instruktoret për mbrojtjen nga infeksionet spitalore sipas ligjit “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve ngjitëse”.

1. Në ambientet spitalore personeli i pastrimit duhet të përdori mjete mbrojtëse si doreza plastike, maska, këpucë gome etj.
2. Në ambjentet publike si koridore, salla, shkallë etj., të përdoren tabela provizore ku të paralajmërohet për dysheme të lagur e të rrëshkitshme.
3. Shërbimi i pastrimit duhet të vazhdojë gjatë 24 orëve pa ndërprerje (sipas ndarjes së orareve të përcaktuara në këtë argumentim.
4. Te siguroje numrin e nevojshem te personelit per kryerjen e pastrimit ne te gjithe teritoret e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore. Ky personel duhet te jete i pershtatshem dhe i instruktuar per kryerjen e sherbimit te pastrimit, sipas rregullave dhe duhet te jete i pajisur me librezat shendetesore personale.
5. Te siguroje bazen materiale te inventarit per pastrim si dhe materialet dezinfektante te pershtateshme dhe te lejueshme per perdorim ne ambjentet spitalore. Siguron inventarin per grumbullimin e mbeturinave ne dhoma, korridore etj.
6. Per personelin e pastrimit siguron veshjet dhe mjetet mbrojtese ne pune te cilat do te jene

## Dokumentat standarde të tenderit

specifike dhe me mbishkrimin perkates.

7. Pastrimi do te behet i perditshem ne te 365 ditet e vitit.

Kontraktuesi do te pastroj çdo dite te gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore sipërfaqen prej 4,450 m<sup>2</sup>, kur është e nevojshme edhe 2 here ne dite, do te pastroj bordurat ne anesoret e rrugëve nga barerat dhe do te lyej bordurat me gelqere nje here ne muaj. Kontraktuesi do te kryej larjen e rrugëve çdo dite heret ne mengjes, para ores 7.00 per periudhen 15 Mars - 30 Tetor, pra gjithsej 230 dite per nje sipërfaqe prej 4,450 m<sup>2</sup>. Kontraktuesi do kryej cdo dite transportin e mbeturinave, (kur është e nevojshme edhe 2 here ne dite) te cilat jane perqendruar ne 1 pika grumbullimi me 6 kazane brenda territorit te spitalit.

Shërbimi i Pastrimit të ambienteve të jashtme që kërkohet do të jetë 16-orarësh sipas tabelës me të dhënat e sipërfaqeve si më poshtë:

Nr	Sipërfaqet e jashtme	Njësia	Sasia	Frekuenca dite/vite	Sasia vjetore
1	Fshirje Rrugë	m <sup>2</sup>	4 450	365	1 624 250
2	Pastrim Rrugesh	m <sup>2</sup>	4 450	365	1 624 250
3	Larje Rrugesh	m <sup>2</sup>	4 450	230	1 023 500

- Me pastrim të jashtëm do të kuptohet pastrimi i sipërfaqeve të rrugëve, trotuareve, shesheve dhe të gjithë territorit pjesë që aktualisht përdoret nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore
- Bordurat duhet të mirëmbahen dhe lyhen me gelqere të paktën një herë në muaj.
- Pastrimi i territorit do të kryhet jo më pak se një here në ditë. Pjesët e asfaltuara dhe të betonuara do të lahen me ujë të paktën 1 (një) herë në ditë sipas sezonit për të eliminuar pluhurat dhe mikrobet (por jo në ditët me shi).
- Territori i Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore në cdo moment duhet të jetë i pastër nga mbeturinat e ndryshme si letra, shishe plastike, amballazhe të ndryshme etj.
- Mbeturinat që do të pastrohen të futen në qese plastmasi dhe të cohen në pikat e grumbullimit të mbeturinave. Duhet ndërruar të paktën një herë në ditë qeset plastike në koshat e vendosura në territorin e jashtëm të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore
- Në asnjë rast mbeturinat të mos digjen.
- Sipermarresi kryen larjen e rrugëve cdo ditë herët në mëngjes, para ores 7.00 për periudhen 15 Mars - 31 Tetor, pra gjithsej 230 ditë.

### Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë

**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >



## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të

## Dokumentat standarde të tenderit

*shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[\_\_\_\_\_]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Dokumentat standarde të tenderit

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES**  
**Shërbimet – Procedura e Hapur**

**Neni 1 Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2 Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3 Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

### **Neni 4 Praktikak Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6 Prona Intelektuale**

